



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10/IA001

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 28 dhjetor 2023

Gjuha e origjinalit: Anglishte

Klasifikimi: **Konfidencial**

Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Zgjatje të Afatit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit:
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit:
Hendrik Sitema

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, "Paneli i Gjykatës së Apelit", "Paneli i Apelit" ose "Paneli" dhe "Dhomat e Specializuara"),¹ në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja"), ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (përkatësisht, "Kërkesa" dhe "ZPS"),² me të cilën kërkon shtyrjen e afatit për dorëzimin e përgjigjes ndaj apelit të z. Sabit Januzi (përkatësisht, "Përgjigjja", "Januzi" dhe "Apeli")³ kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesën e Sabit Januzit për Lirim të Përkohshëm.⁴ ZPS-ja kërkon zgjatjen me një javë të afatit për dorëzimin e Përgjigjes, duke e zgjatur afatin deri më 9 janar 2024.⁵

1. ZPS-ja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e arsyeshme dhe proporcionale të afatit që kërkon sepse, për shkak të periudhës së pushimeve, ka vetëm katër ditë pune midis njoftimit të Apelit dhe afatit aktual për përgjigjen e ZPS-së më 2 janar 2024.⁶ Gjithashtu, ZPS-ja i referohet pushimeve dimërore aktuale.⁷

2. Paneli vë në dukje se, në bazë të rregullës 170(1) të Rregullores, normalisht Përgjigjja duhet të dorëzohet brenda dhjetë ditësh nga shpërndarja e Apelit. Sidoqoftë, Paneli rikujton se rregulla 9(5)(a) e Rregullores lejon ndryshimin e afatit të përcaktuar nga Rregullorja nëse tregohen arsye të vlefshme ose *proprio motu*.

¹ IA001/F00003, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 28 dhjetor 2023 (konfidencial).

² IA001/F00002, Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit të Përgjigjes ndaj Apelit në Emër të Sabit Januzit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, 27 dhjetor 2023 (konfidenciale dhe *ex parte*).

³ IA001/F00001, Apel në Emër të Sabit Januzit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, 21 dhjetor 2023 (konfidencial).

⁴ F00123, Vendim mbi Kërkesën e Sabit Januzit për Lirim të Përkohshëm, 8 dhjetor 2023 (konfidencial).

⁵ Kërkesa, para. 1.

⁶ Kërkesa, para. 2.

⁷ Kërkesa, para. 2.

3. Sa i përket dorëzimit brenda afatit të Kërkesës, Paneli gjykon se ajo është dorëzuar në kohë të mjaftueshme para afatit sipas rregullës 170(1) të Rregullores. Sa u përket arsyeve të vlefshme, Paneli i Apelit thekson se, ndërsa pushimi i gjykatës në vetvete nuk përbën arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit, disponueshmëria e kufizuar e punonjësve gjatë pushimit mund të jetë faktor për miratimin e zgjatjes së afatit.⁸ Gjithashtu, Paneli vëren numrin e kufizuar të ditëve të punës midis njoftimit të Apelit dhe afatit të ZPS-së për të dorëzuar Përgjigjen e vet, për shkak të periudhës së pushimeve dhe faktit se Apeli u shpërnda më 21 dhjetor 2023.⁹ Rrjedhimisht, në rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje dhe në këtë rast të veçantë, duke pasur parasysh parashtrimet e ZPS-së, Paneli konstaton se zgjatja e afatit të kërkuar është e arsyeshme. Në veçanti, Paneli gjykon se zgjatja e afatit të kërkuar nuk ndikon në shpejtësinë e përgjithshme të procesit.

4. Së fundi, Paneli rikujton se, në bazë të rregullës 9(6) të Rregullores, lejohet që vendimet në lidhje me mocionet për ndryshimin e afateve të merren duke mos u dhënë palëve kundërshtuese mundësinë e shprehjes së mendimit. Duke pasur parasysh afrimin e afatit për përgjigjen ndaj Apelit, dhe duke qenë se palëve nuk do t'u shkaktohet dëm, Paneli mendon se është në interes të drejtësisë që vendimi për Kërkesën të merret menjëherë.

⁸ KSC-CA-2023-02, F00004, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 9 janar 2023, para. 6 dhe jurisprudenca e cituar në të. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, IA030/F00003, Vendim mbi Kërkesën e Selimit dhe Krasniqit për Ndryshimin të Afatit, 22 dhjetor 2023, para. 3.

⁹ Paneli vë në dukje se fillimisht Apeli u dorëzua më 20 dhjetor 2023, por pastaj u riparazit dhe u shpërnda më 21 dhjetor 2023, për shkak të një gabimi administrativ.

5. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON Kërkesën; dhe

AUTORIZON ZPS-në të dorëzojë Kërkesën jo më vonë se 9 janar 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E enjte, 28 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë